

NR 417/4 PROF.

Dt. 07.12.2018

Lënda: Kthim pergjigje

Drejtuar: Qendres Kombetare te Kinematografise

Të nderuar,

Në përgjigje të shkresës Tuaj ku kërkohet prononcim lidhur me disa nevoja për strukturimin e KMP-ve që do të funksionojnë pranë Qendrës Kombëtare të Kinematografisë shoqata e APFA shprehet sa më poshtë:

1. Anëtarët e KMP-ve mund të jenë edhe personalitete apo profesionistë të fushës të huaj? **PO/JO**

Në rast se përgjigja do të jetë PO, atëherë duhen zgjidhur dy probleme:

- a. mbulimi i kostos së udhëtimit dhe akomodimit kur anëtari i KMP është i huaj;
- b. përkthimi i skenarëve në gjuhën angleze.

Lutemi argumentimin dhe opsionet Tuaja.

2. A duhet bërë vlerësimi i projekteve me pikë? **PO/JO**

Lutemi argumentimin dhe opsionet Tuaja.

3. A mendoni që janë të rëndësishëm dhe duhet të përfshihen në vlerësimin që anëtarët e KMP-ve do t'i bëjnë projekteve filmike, elementët e mëposhtëm:

I. Cilësia e filmit të mëparshëm të regjisorit, që përbëhet nga këto elementë:

- a. Audiencia në salla në kinematë shqiptare; **1- 5%**
- b. Pjesëmarrja në festivale i filmit të mëparshëm; **1-5%**
- c. Çmimet që ka fituar filmi i mëparshëm. **1 – 10%**
- d. Produksioni **1-10%**

Sa % të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm?

1-30%

II. Cilësia e skenarit konkurrues. 1 - 70%

- a. Konfirmohet se skenari ka fituar zhvillim projekti në Programin Media;
- b. Konfirmohet se skenari është selektuar në një workshop për zhvillim skenari;
- c. Konfirmohet se skenari ka fituar një çmim në vlerë monetare;
- d. Konfirmohet se skenari ka fituar një çmim honorifik.

Sa % të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm?

1- 5% projekti

III. Cilësia e projektit konkurrues.

a. Konfirmohet se projekti ka fituar të drejtën për të marrë pjesë në një forum ndërkombëtar;

b Konfirmohet se projekti është vlerësuar me çmim në një forum ndërkombëtar;

c Konfirmohet se projekti është vlerësuar me çmim financiar në një forum ndërkombëtar.

Sa % të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm?

1- 5 %

IV. Bashkërodhimi që ka siguruar projekti në momentin e aplikimit:

a. Konfirmohet se projekti ka siguruar financimin nga fonde publike të huaja;

b. Konfirmohet se projekti ka siguruar fonde të tjera të besueshme alternative.

Sa % të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm?

1- 5%

V. Projekti duhet të gëzojë avantazh (pasi garanton sukses paraprak) nga përfshirja në të e profesionistëve që i janë bashkëngjitur si më poshtë:

a. Drejtor fotografie të nivelit të lartë;

b. Kompozitor të nivelit të lartë;

c. Aktorë të nivelit të lartë kombëtar, apo ndërkombëtar.

Sa % të kuotave në vlerësimin e çdo anëtari të KMP duhet të meritojë secili nga elementët e mësipërm?

1- 5%

Dhe nga 1-50% te gjykohet cilesia e skenarit si vlere artistike nga ana e bordit

Ju falënderoj për bashkëpunimin.

Kryetari i APFA

Dritan Huqi